



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 10, paragrafit 1.4 të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 35/17, dhjetor 2012), të nenit 20, paragrafi 3, nënparagrafi 3.3 të Rregullores QRK nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 33.2, shkronja **a** dhe të nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinas, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 07.08.2018, miratoi këtë

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT, 01.046-295900, DT. 06.12.2016, PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS MOTRAVE TË SHËN KRYQIT

- I. Miratohet Vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit, 01. 046-295900, dt. 06.12.2016, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Motrat e Shën Kryqit.
- II. Sipas vendimit të cekur në pikën I, plotësim-ndryshimi nënkupton:
 1. Ndryshohet pika II e vendimit, hiqet parcela kadastrale nr. 2786-1, ZK Prishtinë, pronë e Komunës së Prishtinës.
 2. Ndryshohet sipërfaqja e parcelës nr. 2791-1, ZK Prishtinë, nga 117 m² në 269 m².
- III. Vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit 01-463/03-0118225/17, dt. 22.05.2017, të cekur në pikën II, është bërë pasi me ndryshimet e fundit të cilat janë realizuar në regjistrat kadastralë, e bënë të pamundur ekzekutimin e vendimit të lartcekur.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/01-195039/18, më 09.08.2018

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

